

**Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa**



KAB
2012-2014
VUSHTRRI

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

e Komunës së Vushtrrisë për periudhën
2012-2014

I. Hyrje

I. DEKLARATA E DREJTIMIT STRATEGJIK

Korniza Afatmesme Buxhetore është përpiluar si vazhdimësi e kornizave të viteve paraprake, duke u bazuar në dokumentet zhvillimore strategjike afatgjata dhe paraqet mjedisin makroekonomik të komunës sonë, i cili prezanton një përmbledhje të burimeve të planifikuara që janë në dispozicion për financimin e prioriteteve politike dhe makro ekonomike të Komunës. Komuna e Vushtrrisë është e radhitur në mes të Komunave të Republikës së Kosovës si për nga madhësia ashtu edhe për nga numri i banorëve dhe hyn në radhën e komunave më pak të zhvilluara të Republikës së Kosovës me një normë të ulët të investimeve të bëra qysh në kohën e paraluftës së fundit dhe me një numër shumë të madh të papunëve.

Komuna e Vushtrrisë (ende sipas shënimeve jo zyrtare) ka mbi 70.145 banorë, 11.872 ekonomi familjare, me strukturë gjinore 34.123 meshkuj dhe 34022 femra, popullsi e re dhe e aftë për punë, gjithashtu me përgatitje të kënaqshme profesionale. Komuna e Vushtrrisë, sipas shënimeve zyrtare me regjistrimin e vitit 1981 ka pas 65.671 banor me 12 bashkësi lokale dhe me 69 vendbanime. Me regjistrimin e popullsisë të vitit 1971, Komuna e Vushtrrisë ka pasur 50.728 banorë. Shikuar rritjen e popullsisë mes viteve 1971 dhe 1981 rrjedh se popullsia e Komunës sonë është më e madhe për 14.943 ose 29.5%, ndërsa diferenca me numrin e banorëve me regjistrimin e vitit 2011 dhe 1981 është përafërsisht 4.474 banorë, dhe 75.000 banorë sipas Qarkores Buxhetore të MEF-it.

Komuna e Vushtrrisë gjeografikisht shtrihet ndërmjet dy qendrave, Prishtinës dhe Mitrovicës që mundësojnë qasje të lehtë dhe të shpejt në këto tregje shumë të fuqishme. Komuna e Vushtrrisë ka një sipërfaqe prej 345km², duke iu falënderuar kushteve dhe pasurive, e në radhë të parë tokës shumë pjellore e cila ofron kushte shumë të volitshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore lavërtare dhe kopshtare. Vushtria është e njohur sidomos me prodhimin e patates së kualitetit të lartë. Në këtë drejtim kemi edhe industrinë e përpunimit të patates në fshatin Pestovë e cila ka krijuar një rrjet të gjerë të bujqve të cilët merren me prodhimin e kësaj kulture bujqësore duke krijuar të ardhura të mira për familjet e tyre. Njëherit një sasi bukur e madhe e patates eksportohet edhe jashtë tregut të Kosovës. Përvoja dhe vullneti për punë kanë mundësuar që edhe kulturat tjera bujqësore të arrijnë rendimente shumë të larta, dhe me të vërtetë bujqësia është dega me ndikimin më të madh në ekonominë e Komunës dhe është mirëpritur ndihma dhe subvencionimi i bujqëve si nga Ministria e Bujqësisë dhe ndihma nga buxheti komunal. Komuna e Vushtrrisë, pas luftës ka trashëguar një infrastrukturë të dobët dhe të shkatërruar.

Komuna e Vushtrrisë ka të regjistruara 2893 biznese prej të cilave një numër i konsiderueshëm janë prodhuese që merren me prodhim dhe punësojnë një numër të caktuar të punëtorëve, numri më i madh i bizneseve janë nga lëmia e tregtisë me shumicë dhe pakicë dhe përkundër disa objekteve të cilat kanë një numër të madh të punëtorëve. Pjesa tjetër në këtë lëmi punëson një ose dy punëtorë. Procesi i privatizimit në Komunën tonë nuk ka qenë aq i

suksesshëm për arsye se pjesa më e madhe e të punësuarëve janë mbetë jashtë vendeve të tyre të punës dhe përballen me një gjendje të rëndë materiale.

Vetëm vitet e fundit vërehet një aktivitet i shtuar i investimeve nga qeveria qendrore për të përmirësuar sado pak infrastrukturën komunale, dhe në këtë drejtim janë arritur rezultate të konsiderueshme. Bujqësia konsiderohet si shtyllë e zhvillimit ekonomik komunal. Praktikant kanë treguar se nxitja e investimeve të tilla nga komuna dhe qeveria kanë reflektim afatshkurtër në zhvillim, nëse nuk ka nxitje të investimeve të huaja direkte dhe investime vendore.

Investimet e bëra janë sfidë e madhe për komunën, sepse tani paraqitet nevoja për mirëmbajtjen e investimeve kapitale të përfunduara, gjë që do të rrit nevojat për shpenzime operative dhe do të ndeshet me synimet e qeverisë qendrore për uljen e tyre (mirëmbajtja e rrugëve, objekteve shkollore, parqeve të qytetit, ndriçimi i qytetit etj).

Në përgjithësi mirëqenia e banorëve të komunës është në përmirësim të vazhdueshëm dhe synimi i komunës është që të vazhdoj krijimi i kushteve më të përshtatshme për shtimin e interesimit për investimet direkte në dobi të qytetarëve të komunës. Pra, nevojat mbesin ende shumë të mëdha në krahasim me mundësitë.

a. Komuna e Vushtrrisë ka këtë strukturë organizative:

160	Kryetari i Komunës
169	Kuvendi i Komunës
163	Administrata dhe Personeli
175	Buxhet dhe Financa
180	Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencia
195	Zyra Lokale e Komuniteteve
470	Bujqësia, Pylltaria, Zhvillimi Rural
650	Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
660	Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit
730	Kujdesi Primar Shëndetësor (dhe Shërbimet Sociale)
	<ul style="list-style-type: none"> • Administrata komunale shëndetësore • Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor • Shërbimet sociale
760	Përformanca në shëndetësi
850	Kultura, Rinia dhe Sporti
920	Arsimi
	<ul style="list-style-type: none"> • Administrata • Çerdhe dhe Parashkollor • Edukimi Fillor • Edukimi Sekondar

b. Elementet që janë marrë në konsideratë për përgatitjen e KASH-it 2012 – 2014

Korniza Afatmesme Buxhetore e komunës për vitin 2012 – 2014 është planifikuar në bazë të buxhetit i cili bazohet në “Strukturën bazë të programeve “ dhe është i orientuar në objektivat dhe në deklaratat të Misionit të Programeve. KAB 2012 – 2014 është krijuar në përputhje LMFPF¹, LFPL² dhe me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr 2011/01 e cila

¹ Ligji mbi Menaxhimin e Financave të Përgjithshme Publike

² Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal

sfond të vetin dhe kontekst, edhe për këtë periudhë ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve si dhe pretendimet për mbështetje nga donatorët. Është pjesë përbërëse e KASH-it të Republikës së Kosovës. Në KAB-in Komunal do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Vushtrrisë si dhe projektet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2012-2014.

Korniza Afatmesme e Buxhetore është një dokument i cili bënë lidhjen e proceseve buxhetore të politik-bërjes lart – poshtë dhe caktimin e prioritetëve poshtë-lart në formulimin e buxhetit në komunë, ku një gjë e tillë mundësohet me planifikim afatmesëm zakonisht trevjeçar. Korniza paraqet urën lidhëse në mes të strategjisë zhvillimore komunale dhe buxhetit vjetor. Gjithashtu ky planifikim afatmesëm i shpenzimeve ka për qëllim që të rris disiplinën e shpenzimeve të qeverisë lokale në Vushtri.

Një KAB i zbatuar mirë duhet:

- Të lidh prioritet e qeverisë me buxhetin brenda një pakoje të qëndrueshme të shpenzimeve;
- Të theksojë kompromiset brenda objektivave garuese të programeve;
- Të lidhë buxhetin me zgjidhjet e politikave të bëra;
- Të përmirësojë rezultatet duke rritur transparencën, llogaridhënien dhe parashikimin e financimit.

II. OBJEKTIVAT E KAB-it KOMUNAL

a. Objektivat e komunës

Me kornizën Afatmesme parashihen të përmbushën këto objektiva:

- a. Infrastruktura fizike dhe mbrojtja e mjedisit;
 - b. Promovimi dhe mbështetja e biznesit;
 - c. Ngritja e nivelit të arsimit dhe edukimit;
 - d. Zhvillimi i bujqësisë intensive;
 - e. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale;
 - f. Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor;
 - g. Ngritja e efikasitetit të administratës lokale.
- b. Objektivat shtetërore
- Anëtarësimi në BE përmes procesit dhe instrumentit para-anëtarësimit;
 - Rritja ekonomike;
 - Qeverisja e mirë;
 - Kohezioni social;
 - Zbutja e varfërisë dhe kohezioni social.

Siç mund të shihet objektivat e komunës janë të lidhura ngushtë me objektivat e shtetit të Kosovës.

Objektivat e secilës drejtori janë përshkruar në performancën e tyre.

III. POLITIKAT FISKALE TË KOMUNËS (SUPOZIMET EKONOMIKE DHE BUXHETORE)

a. Granti nga Qeveria Qendrore


KAB është një proces i cili zhvillohet gradualisht e që përsëritet çdo vit dhe ka për qëllim të zvogëlojë mosbalancimin në mes asaj që është e përballueshme dhe asaj çfarë kërkohet në programet e Komunës së Vushtrrisë.

Korniza makroekonomike është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH). Gjatë kësaj periudhe të ndërtimit të KAB-it komunal vëmendje e posaçme i është kushtuar të hyrave nga granti i përgjithshëm Komunal dhe nga Grantet specifike për Arsim dhe Shëndetësi, gjersa granti për Sigurim Social do të financohet direkt nga qeveria, kurse në të ardhmen do të jetë nën kompetencat e komunës. Bazuar në KASH –in e RK-së posaçërisht është i rëndësishëm fakti se me ndërtimin e autostradës Merdare-Morinë ekziston mundësia e financimit të saj përmes rialokimit të buxhetit i cili mund të ndikojë edhe në shpërndarjen e grantit të përgjithshëm Komunal, dhe për këtë duhet shtuar kujdesi për grantin e përgjithshëm gjatë kalkulimit të nevojave për shpenzime.

Korniza makroekonomike e komunës është sipas Qarkores nr. 2012/01

Programet	Aktuali 2010	Buxheti 2011	Planifikimi 2012	Vlersimi 2013	Vlersimi 2014
Administrata	3,434,208.95	4,182,775.00	3,801,910.00	3,953,986	4,151,685.32
Shëndetësia	1,145,945.34	1,420,181.00	1,349,200.00	1,403,168	1,473,326.40
Arsimi	4,213,445.08	5,565,611.00	5,569,402.00	5,792,178	6,081,786.90
Të hyrat vetanake	1,086,514.26	1,315,000.00	1,772,000.00	1,842,880	1,935,024.00
Donatorët	74,917.00				
Totali	9,955,030.63	12,483,567.00	12,492,512.00	12,992,212.48	13,641,822.62

Grafikisht lëvizja e buxhetit aktual dhe atij sipas kornizës duket kështu:



Nga të dhënat grafike mund të shihet se të hyrat komunale do të kenë ngritje nga viti në vit si rezultat i rritjes së të hyrave nga granti i përgjithshëm qeveritar, granti specifik për arsim dhe shëndetësi si dhe granti specifik për sigurim social vetëm për vitin 2011.

Për shkak të rrethanave makroekonomike shihet se granti i përgjithshëm gjatë viteve 2012-2014 në krahasim me vitin 2011 pëson një rënie të vogël dhe mbetet sfidë e udhëheqësve komunal që këtë mungesë të grantit ta kompensojnë me ndihmën e donatorëve të jashtëm.

Granti për shëndetësi pëson të njëjtën rënie sikur edhe granti i përgjithshëm, granti për Arsim ka një ngritje të lehtë dhe të vazhdueshme.

b. Parashikimi i të hyrave vetjake komunale

Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetjake komunale.

Me kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012-2014 është paraparë ndërmarrja e një varg masash duke filluar nga përpjekjet për implementimin e politikave të qëndrueshme fiskale, zotimi i qeverisë për t'iu përmbajtur rregullës fiskale sipas dokumentit të KASH-it, rekomandimeve të FMN-së dhe zbatimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Bazën e të hyrave komunale e përbën Tatimi në Pronë dhe këto të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, arsim, shëndetësi, ujësjellës, kanalizim etj.

Të hyrat e komunës përbëhen nga:


- i. Tatimi në pronë;
- ii. Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste;
- iii. Taksat për lejen për shërbime profesionale;
- iv. Taksat për automjete motorike;
- v. Taksa administrative komunale;
- vi. Taksa për leje ndërtimi;
- vii. Taksa për certifikata;
- viii. Qiraja nga objektet;
- ix. Bashkë-pagesat në arsim;
- x. Bashkë-pagesat në shëndetësi;
- xi. Renta e tokës;
- xii. Të hyrat tjera (dhëniet nga donatorët dhe pjesëmarrja e qytetarëve), por në detaje shiko tabelën vijuese.

Përveç të hyrave nga tatimi në pronë edhe taksa komunale në biznes tregon një kategori të rëndësishme të hyrave vetjake komunale. Gjatë planifikimit të kësaj kategorie kemi pas parasysh që një numër i konsiderueshëm i bizneseve komunale nuk janë duke funksionuar. Taksa komunale për leje ndërtimi është gjithashtu një kategori e rëndësishme e të hyrave, gjatë planifikimit të kësaj kategorie, komuna ende nuk është e sigurt me kategorinë e legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje. (Sipas disa analizave llogariten se është një numër i madh i shtëpive pa leje, disa prej tyre janë objekte të mëdha dhe të mesme që presin legalizimin e tyre). Të hyrat nga bashkë-pagesat në arsim dhe posaçërisht në shëndetësi janë mjaft konstante, mbetet që përgjegjësit e këtyre dy programeve gjatë diskutimeve buxhetore të ofrojnë të dhëna më të kompletuara mbi këto dy kategori të rëndësishme të të hyrave.

Të hyrat nga lëshimi i dokumentacioneve administrative do të jetë përafërsisht i njëjtë nëpër vite, duke u bazuar në përvojat e viteve të kaluara, kërkesa për këto dokumentacione gati ishte konstante.

Përmbledhja e planifikimit të të hyrave aktuale vetanake 2011 dhe plani për vitin 2012 dhe vlerësimet për vitin 2013 dhe 2014 janë të paraqitura në tabelën vijuese:

22	Inspektimet dhe matjet në terren	50504	57,704	66,000	66,000	66,000
23	Pagesat tjera		170		135,500	
Totali i të hyrave publike			678,261	950,217	1,640,000	1,472,000
22	Të hyrat nga gjobat në trafik		27,690	21,000	21,000	21,000
23	Të hyrat nga gjobat në gjykatë		123,505	110,000	111,000	111,000
24	Të hyrat tjera /agjensioni i pyjeve/		534			
Totali i të hyrave nga gjobat			151,729	131,000	132,000	132,000
25	DONACIONET E BRENDSHME		93,630	233,783	250,000	260,000
T O T A L I			829,990	1,081,217	1,772,000	1,604,000
			829,990	1,081,217	1,772,000	1,604,000
			829,990	1,081,217	1,772,000	1,604,000
Grafikisht te hyrat e planifikuar me KAB duken kështu:						



Sa i përket të hyrave nga donatorët e mundshëm deri në këtë moment të planifikimit të tyre, nuk kemi mundur t'i identifikojmë donatorët potencial.

IV. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE
(Vlerësimet e Hershme Buxhetore 2012-2014)

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Komunale është bërë për këta Sektorë – Programe Komunale dhe përfshin këto vite buxhetore :

Bazuar në kufijt fillestar nga Qarkorja buxhetore e Ministrit për MEF dhe të hyrave vetjake komunale për vitin 2012-2014, totali i shpërndarjes së tyre është:

Nr.	Programi	Buxheti	Planifikimi	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi
		2010	2011	2012	2013	2014
1	Zyra e Kryetarit	54,154.87	116,565.00	116,565.00	121227.6	127288.98
2	Zyra e Kuvendit Komunal		137,900.00	129,000.00	134160	140868
3	Administrata dhe personeli	333,991.38	361,201.00	361,201.00	375649.04	394431.492
4	Inspektimet	69,957.57	77,751.00	78,500.00	81640	85722
5	Prokurimi	33,247.46	24,716.00	25,500.00	26520	27846
6	Buxheti dhe financat	106,168.89	119,798.00	119,798.00	124589.92	130819.416
7	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	1,434,051.59	1,224,920.00	1,223,432.00	1272369.28	1335987.744
8	Zyra komunale për komunitete dhe kthim	49,938.54	48,317.00	44,500.00	46280	48594
9	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural	82,639.41	2,753,160.00	2,900,831.00	3016864.24	3167707.452
10	Kadastra dhe gjeodezia	46,516.06	82,123.00	82,123.00	85407.92	89678.316
11	Planifikimi urban dhe mjedisi	1,697,348.93	241,026.00	241,026.00	250667.04	263200.392
12	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	1,346,445.64	1,475,253.00	1,349,200.00	1403168	1473326.4
13	Kultura, rinia dhe sportet	327,022.42	225,225.00	225,225.00	234234	245945.7
14	Arsimi dhe shkenca	4,267,202.29	5,595,611.00	5,595,611.00	5819435.44	6110407.212
	Gjithsejt	9,848,685	12,483,566	12,492,512	12,992,212	13,641,823

Specifikacioni :

Komuna e Vushtrrisë	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
	9.848.685	12.483.566	12.492.512	12.992.212	13.641.823

V. INDIKATORËT E PERFORMANCËS

STRATEGJIA ZHVILLIMORE PËR SEKTORËT KOMUNAL

Zyra e Kryetarit

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit: Përgatitja dhe prezantimi i të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë e Financa në kuadër të kompetencave dhe fushë veprimtarisë të nivelit të qeverisjes lokale nga fushëveprimtaria e vet e paraparë me Ligj (nxjerrja e rregulloreve, vendimeve, udhëzimeve etj) në funksion të qeverisjes sa më të mirë dhe efikente të gjitha drejtorive të shërbimit civil të Komunës, gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve me të gjitha drejtoritë e Shërbimit Civil të Komunës, këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, Komiteteve të obligueshme dhe Komiteteve jo të obligueshme, me subjektet relevante të Nivelit Qendror dhe atij lokal, OJQ-të, biznesin, etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

Vlerësimi i mundësive dhe sfidave gjatë periudhës buxhetore:

Realizimi sa më i mirë dhe me planin e të hyrave buxhetore komunale do të ndikonte në realizimin e projekteve të ndryshme kapitale dhe zhvillimore të Komunës, derisa ngecja në mospërbushjen e tyre do të ndikonte në ngadalësimin e synimeve të tyre dhe me këtë edhe në zhvillimin e tërësishëm të Komunës.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe sfidave (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Një punë me efikase e Kuvendit të Komunës, komiteteve obligative dhe komiteteve jo obligative për realizimin e përgjegjësive, punëve dhe detyrave në të ardhmen do të ndihmonte në përshpejtimin e realizimit të programeve zhvillimore në nivelin komunal.

Strategjia e Drejtorisë Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit:- Bën përgatitjen dhe prezantimin e buxhetit komunal, menaxhimin e buxhetit dhe financave të Komunës, përgatitjen e raporteve periodike dhe pasqyrat financiare vjetore, i siguron drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon menaxherët kryesor komunal me aktivitetet e ndërlidhura me buxhetin e komunës.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve me të gjithë drejtorët e Komunës dhe organizatat buxhetore komunale për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e buxhetit konform limiteve të përcaktuara nga MEF-i dhe të dhënave përmes qarkoreve buxhetore, zhvillimi i KAB –it komunal sipas standardeve më të larta për nivelin e administratës lokale, bashkëpunimi i ngushtë me MEF-in dhe të gjitha ministrinë e Republikës së Kosovës në sferën e buxhetit dhe financave.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Mos realizimi i të hyrave vetjake komunale janë një ndër kërcënimet më serioze për realizimin e planit të buxhetit komunal si pasojë mund të vijë deri te reduktimi i investimeve kapitale të parapara me buxhet. Gjithashtu edhe reduktimet eventuale nga qeveria qendrore mund të paraqesin kërcënim për realizim të planit.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Qëndrueshmëria buxhetore dhe menaxhimi me efikasitet dhe efektivitet sipas dinamikës së rrjedhës së parasë i shpenzimeve për të gjitha kategoritë ekonomike dhe sidomos ato që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik-investimet kapitale. Bashkëpunimi i ngushtë në mes të MEF-it dhe të gjitha drejtorive komunale me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Objektivi i Drejtorisë

Hartimi i pasqyrave financiare dhe barazimi i të hyrave dhe të dalave.

Strategjia e Drejtorisë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Shëndetësi Mirëqenia Sociale

Deklarata e misionit: DSHMS-ja ka për mision të vetin të sigurojë, përmirësoj dhe ofrojë qasje në shërbime cilësore të kujdesit primar shëndetësor, staf mjekësor të shkathët dhe programe inovative si dhe të zhvillojë sistemin e ofrimit të mbrojtjes parësore shëndetësore sa më kualitative duke u bazuar në nevojat e popullatës në tërë territorin e komunës dhe përkujdesjen sociale të gjithë banorëve, veçmas të atyre me status të rëndë social, gjithmonë në kuadër të mundësive buxhetore dhe profesionale. Funksinin e saj e kryen përmes kujdesit primar shëndetësor, Qendrës për Punë Sociale dhe Administratës. Bashkëpunimin e ngushtë në mes të programeve komunale, Ministrisë së

Shëndetësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, MEF-it si dhe donatorët e mundshëm të cilët shprehin interes për bashkëpunim.

Kujdesi parësor shëndetësor

Deklarata e misionit: Synimi kryesor është ofrimi i kujdesit parësor shëndetësor i gjithë popullatës pa dallim moshe, gjinie race, religjioni. Të gjitha shërbimet shëndetësore kryhen përmes QKMF-së, QMF-së dhe ambulancave dhe ofrohen këto shërbime: shërbimet e mjekësisë familjare, kujdesit të fëmijëve, kujdesit të grave në maternitet, shërbimet stomatologjike, vaksinimi, emergjenca dhe diagnostikimi, shërbimi informativ kompjuterik dhe telemjekësia.

Qendra për Punë Sociale

Deklarata e misionit: Kjo qendër kryen këto shërbime: shërbimet e asistencës sociale, shërbimet sociale dhe shërbimet administrative financiare.

Dhënia e **asistencës sociale** bëhet në bazë të ligjit 2003/15, përmes aplikimit që më vonë komisioni pas verifikimit të gjendjes në terren vendos për mbështetje.

Shërbimet sociale kryhen sipas nevojave të qytetarëve. Janë mbi 50 lloje të shërbimeve: si shërbimet për fëmijë jetimë, braktisja e fëmijëve, fëmijët pa përkujdesje, adoptimi i fëmijëve, sjellja asociale, përkujdesja për të moshuarit pa mbështetje të prindërve etj.

Administrata

Deklarata e misionit: Administrata është përgjegjëse për sigurimin e personelit të drejtorisë me udhëzime, politika dhe procedura për menaxhimin dhe implementimin e aktiviteteve, menaxhimin e buxhetit dhe të financave të drejtorisë dhe mbikëqyrë punën dhe aktivitetin e përgjithshëm të shëndetësisë primare përmes QKMF –së, QMF-së dhe ambulancave në terren

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

- Parandalimin dhe zvogëlimin e sëmundshmërisë, paaftësisë dhe vdekjet e parakohshme nga sëmundjet kronike, çrregullimet mendore, dhuna dhe lëndimet;
- Zvogëlimi i morbiditetit dhe mortalitetit dhe përmirësimi i shëndetit gjatë fazave kyçe të jetës, duke përfshirë shtatëzaninë, shëndetin reprodaktiv të fëmijës dhe promovimin e jetës aktive dhe të shëndetshme të individëve;
- Zvogëlimi i pasojave të situatave emergjente me qëllim të minimizimit të efektit të tyre në jetën sociale dhe ekonomike;
- Promovimi i jetës së shëndetshme dhe parandalimi apo reduktimi i faktorëve të rrezikut për shëndetin si: duhani, alkooli, drogat dhe substancat tjera psikoaktive, dieta, mosaktiviteti fizik etj;
- Adresimi i faktorëve ekonomik dhe social dhe programeve që e akcentojnë barazinë dhe integrojnë çasjet pro rasteve me varfëri të skajshme, baza gjinore dhe të bazuara në konventat e të drejtave të njeriut;
- Promovimi i ambientit të shëndoshë duke adresuar faktorët ambiental që kërcenojnë shëndetin publik;
- Përmirësimi i ushqyeshmerisë në kuptim të ushqimit të shëndoshë.

Si të arrihet?

Duke marrë parasysh faktin së shërbimet e KPSH-së ofrohen në Institucionet Publike, politikat qendrore kanë ndikim të madh në zhvillimin e këtyre shërbimeve. Strukturat e qeverisjes lokale kanë për obligim të mbështesin aktivitetet e KPSH-së në kuadër të mundësive buxhetore. Komuna e Vushtrrisë, si komunë me të hyra vetanake të ulëta, me vështirësi mund të përballon nevojat e qytetarëve për shërbime shëndetësore. Ajo që mund të arrihet është:

- Shpërndarja e shërbimeve të kujdesit shëndetësor sa më afër pacientit (aktivizimi i plotë i ambulancave të mjekësisë familjare – mjeku çdo ditë pune në ambulancën familjare më të afërt);
- Punësimi i mjekëve me qëllim të arritjes së kuotës së paraprë me strategji shëndetësore: në 2000 banorë një mjek (duke mos pranuar staf teknik të ri – infermier, në vend të atij që pensionohet apo largohet nga vendi i punës për ndonjë arsye tjetër dhe duke i zëvendësuar me mjekë të rinj);
- Zëvendësimi i stafit teknik që largohet me staf mjekësor – në vend të vozitësve dhe stafit tjetër administrativ të pranohen infermierë me leje të vozitjes, çka mundëson shfrytëzimin e plotë të resurseve në dispozicion);
- Kontraktimi i disa shërbimeve (transporti i pacientëve në hemodializë – e ulë koston e shërbimeve duke eliminuar nevojën për blerjen e automjeteve të reja, mirëmbajtja e tyre, punësimi i stafit të nevojshëm etj).

Kostoja në baza vjetore:

- Punësimi i 3 mjekëve jashtë listës aktuale (12.000 €);
- Zëvendësimi i stafit teknik dhe administrativ që largohet (pensionohet) me staf mjekësor – infermier, parashikimi për 6 punëtorë (12.000 €).

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Ofrimi i shërbimeve të Kujdesit Primar Shëndetësor në nivel komune përcillet me rreziqe dhe kërcënime që janë të natyrës kryesisht buxhetore e që pak a shumë janë të varura nga niveli qendror si:

- Mosmiratimi i Ligjit për Sigurime Shëndetësore,
- Politikat sociale joadekuate (rastet sociale përfitojnë nga skemat sociale në fusha të ndryshme por jo edhe në shërbime shëndetësore),
- Mospërputhshmëria e grantit qeveritar për shëndetësi më numrin real të banorëve të komunës së Vushtrris (llogaritja e grantit bëhet për rreth 75.000 banorve sa llogaritet të ketë aktualisht komuna),
- Kufizimi i mundësisë për të pranuar staf të ri mjekësor, në lidhje me numrin e kufizuar të punësuarve, çka ndikon që një numër mjekësh të presin për punë, për një periudhë të gjatë kohore e në anën tjetër një numër ambulancash në teren të mos kenë mjek të rregullt.
- Niveli i ulët i bashkpagesave për shkak të liritimit të numrit të madh të pacientve nga bashkpagesat, bazuar në aktet ligjore dhe nenligjore të aprovuara,
- Niveli i lartë i shkallës së varferisë dhe papunësisë në komunë etj.
- Shkalla e lartë e popullësisë e moshës vullnerabile (fëmijë, moshë reproduktive, rini shkollore, pleq etj.)

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Zyra për kadastër është përgjegjëse të kujdeset për mirëmbajtjen e të gjithë regjistrave kadastral ku përfshihet e tërë paluajtshmëria komunale. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë është përgjegjëse për të mbajtur marrëdhënie të ngushta me qeverinë qendrore – Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Shërbimeve Publike, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Agjensionin Kosovar të Mirëbesimit. Kryhen të gjitha veprimet procedurale lidhur me uzurpimet, ekspropriimet, nxjerr të gjitha aktet juridike që ndërlidhen me fushat e cekura. Të menaxhojë çështjet buxhetore dhe financiare të drejtorisë dhe stafit, të nxjerr politika dhe rregulla për menaxhimin e drejtorisë.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve të administratës me zyrën e kadastrës, zyrën e gjeodezisë dhe zyrës për pronë.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Mosrealizimi i parashikimeve i të hyrave komunale.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Qëndrueshmëria buxhetore ...

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Ambient

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit:- Bën planifikimin dhe zhvillimin e Planit hapësinor dhe urban të Komunës, harton programet dhe Planet urbane, planet e përgjithshme dhe detajet urbanistike, planet për vendbanime dhe të rajoneve si dhe implementimin e këtyre planeve, lëshon lejet e ndërtimit, lejet për adoptimin e ndërtesave, lëshon lejet për infrastrukturë (sistemit të furnizimit me ujë, kanalizimit, rrugëve etj. Bën mirëmbajtjen e rrugëve të Komunës, ndriçimin publik dhe të rrugëve, mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe ujësjellësit etj.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve në mes të drejtorive si: Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe organeve qendrore, komunitetit-qytetarëve dhe institucioneve tjera relevante.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Nëse të hyrat vetjake komunale nuk realizohen sipas planit, mund të vijë deri te reduktimi i planeve urbane dhe zhvillimore komunale.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive the kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Qëndrueshmëria buxhetore, çështjet pronëso-ro-juridike të padefinuara etj.

Strategjia e Drejtorisë

Drejtoria për Arsim

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit: DA-ja ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj në bazë të Ligjit për organizimin dhe arsimimin për fëmijë dhe të rritur. Të sigurojë barazi për të ndjekur arsimimin parashkollor, fillor dhe të mesëm të të gjithë qytetarëve të komunës, përfshirë edhe pakicat/minoritetet të mbështesë zhvillimin dhe aftësimin e personelit, të nxis bashkëpunimin midis mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve në mes të organeve lokale dhe qendrore të arsimit, bashkëpunimi me të gjitha institucionet arsimore etj.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Mungesa e mjeteve buxhetore do të vështirësonte kushtet teknike për një shkollim sa më kualitativ.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Ofrimi i mundësive për shkollim të të gjithë qytetarëve duke u bazuar edhe në mundësitë e mjeteve buxhetore.

Strategjia e Drejtorisë

Sektori për Kulturë, Rini dhe Sport

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet)

Deklarata e misionit: Krijimi dhe mbështetja e subjekteve dhe individëve krijues kulturor, aktiviteteve rinore dhe sportive në nivel të komunës. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm vlerash konkurruese.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale)

Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve me subjektet e ndryshme krijuese. Mbështetja e avancuar e krijuesve kulturor e artistik në ndërmarrjet konkrete dhe aktivitetet me interes të veçantë përfaqësimi. Koordinimi i aktiviteteve me organizatat rinore dhe avancimi i pjesëmarrjes së të rinjëve në politikat e zhvillimit kulturor dhe aktiviteteve rinore masivizuese.

Koordinimi me të gjitha klubet sportive dhe krijimi i hapësirave për aktivitete rekreative – sportive dhe garave konkurruese në nivele të ndryshme.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore

Potenciali krijues dhe organizativ shpesh nuk është në përputhje me mundësitë buxhetore. Mungesa e buxhetit e pezullon aktivizimin e synimeve programore të zhvillimit.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen)

Avancimi i politikave buxhetore në mbështetje të synimeve për zhvillimin e kulturës, artit, masivizimin dhe funksionalizimin e aktiviteteve rinore dhe sportive, krijimi i kushteve sa më të favorshme për zhvillimin e kulturës, deri te gjetja e modelit specifik të zhvillimit të kulturës në bazë të resurseve ekzistuese të specifikuara. Gjetja e hapësirave të reja shprehëse dhe mbështetëse për zhvillimin e proklamuar të kulturës, aktiviteteve rinore dhe sportive për të gjithë.

Strategjia e Drejtorisë

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Përmbledhja e rrjedhimeve që kërkohen në arritjen e synimeve

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural bën menaxhimin e stafit të drejtorisë, planifikimin e projekteve kapitale dhe bën koordinimin me agjencionet tjera qeveritare për aktivitete bujqësore dhe zhvillim rural në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale)

Përgatit planin për mbjellje vjeshtore dhe pranverore dhe siguron që këto plane të zbatohen, koordinon punët me OJQ-të me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve bujqësore, lidh dhe bashkëpunon me kooperativat bujqësore për t’iu ofruar trajnime dhe shërbime tjera veterinarë, blegtorale etj. Poashtu koordinon edhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të gjuetisë, pylltarisë etj. Resurset bujqësore si: toka pjellore e mjaftueshme dhe cilësore për kultivimin e pemëve dhe perimeve është prioritet ndër prioritetet bujqësore afatmesme.

Ruajtja – mbrojtja e tokës bujqësore nga copëtimi i mëtutjeshëm dhe nga ndërtimet në tokat bujqësore.

Përmirësimi i kushteve (deri më tani të pa volitshme) për kreditimin e fermerëve, investimeve të ndryshme në bujqësi si dhe investimet e kapitalit të punëtorëve që kishin me u kthye nga bota e jashtme.

Ngritjen e minifermave në fshatra dhe mbushjen e tyre me lopë qumështore, me viça për trashje, pra për majmëri etj.

Blerja –ngritja e një numri fermash të deleve, dhive etj, aty ku ka kushte të volitshme për mbajtjen e tyre.

Investime në ngritjen e ndonjë qumështoreje për përpunimin e qumështit një ditë dhe atij në “tetrapak” .

Investime në rritjen e numrit të fermave të pulave vojse, zogjve për trashje (bojlerëve) etj.

Bashkëpunojmë me fermer që posedojnë bletë dhe mundohemi për rritjen e numrit të tyre pasi që bletarët e komunës sonë kanë një traditë në kultivimin e bletëve.

Investime në rritjen e grumbullimit të bimëve mjekuese dhe prodhimeve pyjore si (këpurdhave) dhe bimëve tjera pyjore.

Investime në turizëm, pasi që treva e komunës posedon kushte ideale për këtë lëmi.

Vlerësimi i mundësive dhe nevojave për periudhën buxhetore:

Plani i realizimit të misionit do të vështirësoj, nëse nuk përmbushen të hyrat buxhetore. Kushtet atmosferike që do të ndikojnë në realizimin dhe rendimentet e lartë cekura.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitete) të propozuara

Kushtet atmosferike që do të ndikojnë në rendimentet bujqësore duhet të trajtohen dhe t’u ipet një tretman i posaçëm, pasi që ka ndikim të madh në bujqësi si: të reshurat atmosferike-breshëri, ngricat e ndryshme, vërshimet etj.

V. PROJEKSIONET E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT KOMUNAL

a. Projektionet e shpenzimeve të buxhetit komunal sipas limitit të parë buxhetor të arritur nga MEF-i.

Nga MEF-i, me dt. 24.05.2011 kanë arritur limitet e para buxhetore për komunat për periudhën 2012-2014. Granti fillestar i Qeverisë për Komunën e Vushtrrisë është si vijon:

Viti	Granti specifik për administratë	Granti specifik për arsim	Granti specifik për shëndetësi	Gjithsej Qendror
2011	4,182,775.00	5,565,611.00	1,420,181.00	11,168,567.00
2012	3,801,910.00	5,569,402.00	1,349,200.00	10,720,512.00
2013	3,801,991	5,721,482	1,578,059	11,101,531.41
2014	3,954,086.70	5,989,882.34	1,702,662.12	11,646,631.15

Të hyrat e brendshme, së bashku me grantin nga Qeveria e RK-së sipas viteve

(Vlerësimet tona për tri vitet në vijim)

Viti	Granti qendror	Të hyrat vetjake
2011	11.168.567,00	1,315,000.00
2012	10.720.512,00	1,772,000.00
2013	11.101.531,41	1,472,000.00
2014	11.646.631,15	1,512,000.00

Pas shqyrtimit të Qarkores buxhetore 01/2011 si dhe pas dëgjimeve publike me qytetarët, përgatiten projektet kapitale për vitin 2012-2014. Përderisa pagat tregojnë një vijë të drejtë në bazë të kufijve buxhetor, është kërkesë edhe e MEF-it që mallrat dhe shërbimet së bashku me komunalitë dhe subvencionet kanë një rritje të lehtë, ndërsa synimi i komunës është që të rriten shpenzimet në investimet kapitale, gjë që e kemi arritur me këtë lloj të planifikimit.

PIP

Programi komunal për investime publike përfshinë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2012-2014 nga ana e Kuvendit të Komunës sipas proceseve buxhetore të zhvilluara gjatë vitit 2011.

Listën e projekteve kapitale të parapara me Buxhetin e vitit 2011, 2012, 2013 dhe 2014 të parapara nga granti dhe të hyrat vetjake.

Kjo listë do të modifikohet me propozime të reja që do të vijnë nga drejtoritë gjatë dëgjimeve buxhetore me drejtorët e drejtorive dhe strukturat tjera udhëheqëse dhe organet relevante komunale për hartimin e politikave zhvillimore të Komunës, duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për financim, si dhe aftësive dhe burimeve të të ardhurave komunale, siç janë: grantet e Qeverisë së Kosovës, të hyrat vetjake dhe donatorët e ndryshëm.

Prioritetet e Komunës së Vushtrrisë kryesisht janë të orientuara në ngritjen e infrastrukturës rrugore, ndërtimin e ujësjellësve dhe kanalizimeve nëpër bashkësi lokale dhe fshatra, infrastrukturë arsimore, bujqësi, kulturë dhe mirëqenie sociale.

Për këtë qëllim komuna është e orientuar që burimet e financimit për këto projekte t'i kërkojë tek donatorët e mundshëm dhe ministritë përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryetari i Komunës,
Bajram Mulaku